



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/159
Datë: 13.09.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 shtator 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Ekstrakti i Procesverbalit dhe Transkripti i mbledhjes së 153 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/159

Datë: 13.09.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 shtator 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Shërbime Sociale dhe Familjare.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/159
Datë: 13.09.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 shtator 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Falimentimin.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/159

Datë: 13.09.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 shtator 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare ndërmjet Kosovës nga njëra anë dhe Bashkimit Evropian nga ana tjetër për Pjesëmarrjen e Kosovës në Programin e Bashkimit "Programi i Tregut të Vetëm".
2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/159

Datë: 13.09.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 shtator 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Raporti për Vlerësimin *Ex-Post* për Ligjin Nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi.
2. Obligohet Zyra Ligjore në Zyrën e Kryeministrit që në procesin e ardhshëm të planifikimit legjislativ të merr parasysh gjetjet dhe rekomandimet e Raportit për Vlerësimin *Ex-Post* për Ligjin Nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi.
3. Pjesë e këtij Vendimi është Raporti për Vlerësimin *Ex-Post* për Ligjin Nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi.
4. Raporti i dërgohet për informim Kuvendit të Kosovës në përputhje me Përfundimin e Kuvendit Nr. 08-P-048.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/159
Datë: 13.09.2023


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, si dhe në Strategjinë për Zhvillim Industrial dhe Mbështetje të Biznesit 2030, e miratuar me Vendim të Qeverisë Nr. 18/148, në mbledhjen e mbajtur me 29.06.2023, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 shtator 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Këshilli për Zhvillim të Industrisë (në tekstin e mëtejshëm "Këshilli")
2. Këshilli përbëhet nga:
 - 2.1. Ministria e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, kryesuese;
 - 2.2. Përfaqësues i Departamentit të Industrisë, MINT - anëtar;
 - 2.3. Përfaqësues nga KIESA, MINT - anëtar;
 - 2.4. Përfaqësues nga Zyra për Planifikim Strategjik, ZKM - anëtar;
 - 2.5. Përfaqësues nga Departamenti për Ekonomi dhe Tregti, ZKM - anëtar;
 - 2.6. Përfaqësues nga Universiteti i Prishtinës, Fakultetet që ndërlidhen me sektorët e industrisë - anëtar;
 - 2.7. Përfaqësues nga Departamenti për Politika Ekonomike dhe Fiskale, MFPT- anëtar;
 - 2.8. Përfaqësues nga Departamenti për Punë dhe Punësim, MFPT - anëtar;
 - 2.9. Përfaqësues nga Departamenti i Minierave, ME - anëtar;
 - 2.10. Përfaqësues nga Departamenti i Arsimit Profesional, MASHTI - anëtar;
 - 2.11. Përfaqësues nga Departamentit për Analiza Ekonomike dhe Statistika Bujqësore, MBPZhR - anëtar;
 - 2.12. Përfaqësues nga Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ujërave, MMPHI- anëtar;
 - 2.13. Përfaqësues nga Departamenti për Diasporë, MPJD - anëtar;
 - 2.14. Përfaqësues nga Departamenti për Zhvillim të Qëndrueshëm Komunal, MAPL - anëtar;
 - 2.15. Përfaqësues nga Oda Ekonomike e Kosovës - anëtar;
 - 2.16. Përfaqësues nga Shoqatat Industriale - anëtar;
 - 2.17. Përfaqësues nga OJQ përfaqësuese të Grave në biznes - anëtar.
3. Këshilli ka për qëllim zhvillimin e dialogut mes nivelit qeveritar dhe sektorëve industrial privat. Këshilli ka për synim rritjen e transparencës në vendimmarrjen publike dhe përfaqësimin e sektorit industrial në hartimin e rekomandimeve për Qeverinë e Republikës së Kosovës, lidhur me masat konkrete për nxitjen e zhvillimit të industrisë vendore në linjë me politikën industriale si dhe në përputhje me Strategjinë për Zhvillim Industrial dhe Mbështetje të Biznesit.
4. Sipas nevojës dhe rrethanave, Këshilli mund të kërkojë informata shtesë dhe ekspertizë prej Institucioneve relevante të Republikës së Kosovës dhe ekspertëve të jashtëm.

5. Këshilli mund të themelojë grupe punuese, të cilat janë të fokusuara në prioritetet dhe fushat e përcaktuara për zhvillim industrial.
6. Sipas nevojës, çështjes dhe rrethanave, Këshilli mund të thërras në takim edhe institucione dhe organe të tjera qeveritare dhe përfaqësues të grupeve të interesit.
7. Këshilli do të organizon së paku 4 takime të rregullta në vit. Në raste të caktuara, Këshilli mund të organizon takime shtesë.
8. Sekretariati i Këshillit do të ushtrohet nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, respektivisht Departamenti i Industrisë, i cili do të kryen punët administrative dhe teknike.
9. Këshilli, sipas nevojës dhe kërkesave, ofron raporte dhe komente në Qeveri, duke u bazuar në punën e Këshillit.
10. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/159
Datë: 13.09.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 29 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063, me Ligjin Nr. 05/L-007, nenit 14, paragrafi 1. të Ligjit Nr. 08/L-0193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-213 dhe Ligjin Nr. 08/L-235, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 shtator 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet ndarja e mjeteve buxhetore në shumë prej 500,000.00 (pesëqind mijë euro) për mbështetje financiare për familjet e ndikuara nga tërmeti në Turqi.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij Vendimi ndahen nga Shpenzimet e Paparashikuara me kod 232 nën-programi "Shpenzimet e Paparashikuara" me kod 13100, kategoria e shpenzimeve "Rezerva" dhe transferohen në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve me kod 201 në nën-programin "Thesari" me kod 11200, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere".
3. Obligohet Thesari që të realizojë transferin e mjeteve sipas pikës 1. të këtij Vendimi në llogarinë bankare të përcaktuar nga Qeveria e Turqisë dhe të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij Vendimi në bashkëpunim me Ambasadën e Turqisë.
4. Obligohet Ministria e Financave Punës dhe Transfereve për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/159
Datë: 13.09.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4, 9, 10 dhe nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 shtator 2023, merr këtë:

V E N D I M P R E L I M I N A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik të pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga realizimi i Projektit: Zgjerimi i Rrugës Rajonale, R 115 Prizren Prevallë, Zona Kadastrale: Gornje Sellë, Komuna Prizren, sipas tabelave të bashkëngjitur këtij Vendimi.
2. Obligohet Departamenti i Shpronësimit që brenda 5 (pesë) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij Vendimi Preliminar, t'i njoftojë pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen dhe brenda afatit prej 10 (dhjetë) ditëve të punës pas miratimit të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Kosovës.
3. Kundër këtij Vendimi apo cilës do pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike në Gjykatën Kompetente, subjekti kërkues dhe cili do person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky Vendim.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës) dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.
5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/159

Datë: 13.09.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4, 9, 10 dhe nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 shtator 2023, merr këtë:

V E N D I M P R E L I M I N A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik të pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga realizimi i Projektit: Zgjerimi i Rrugës Rajonale, R 115 Doganaj-Shtërpçë, Zonat Kadastrale: Viqë dhe Drekok, Komuna Shtërpçë, sipas tabelave të bashkëngjitur këtij Vendimi.
2. Obligohet Departamenti i Shpronësimit që brenda 5 (pesë) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij Vendimi Preliminar, t'i njoftojë pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen dhe brenda afatit prej 10 (dhjetë) ditëve të punës pas miratimit të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Kosovës.
3. Kundër këtij Vendimi apo cilës do pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike në Gjykatën Kompetente, subjekti kërkuar dhe cili do person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky vendim.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës) dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.
5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/159
Datë: 13.09.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4, 9, 10, 44 dhe nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 shtator 2023, merr këtë:

V E N D I M P R E L I M I N A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik të pronës së paluajtshme ish shoqërore P. Sh IGK "Ballkan" Njësia Damper, (ish Kampi "Casablanka"), për nevoja të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës, parcela kadastrale Nr. 2307-2, Zona Kadastrale: Suharekë, Komuna Suharekë, sipas tabelës të bashkëngjitur këtij Vendimi.
2. Obligohet Departamenti i Shpronësimit që brenda 5 (pesë) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij Vendimi Preliminar, t'i njoftojë pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen dhe brenda afatit prej 10 (dhjetë) ditëve të punës pas miratimit të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Kosovës.
3. Kundër këtij vendimi apo cilës do pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike në Gjykatën Kompetente, subjekti kërkuar dhe cili do person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky Vendim.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës), Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Mbrojtjes.
5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/159
Datë: 13.09.2023


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 3, 4, 8, 44 dhe nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 shtator 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet shqyrtimi i mëtejme i kërkesës së Komunës së Prizrenit për shpronësim për interes publik të pronës së paluajtshme ish shoqërore N. Sh. KBI "Progres" e cila është e nevojshme për realizimin e Projektit: "Varrezat e Qytetit të Prizrenit", Zona Kadastrale: Landovicë, Komuna Prizren, sipas tabelës të bashkëngjitur këtij Vendimi.
2. Vlera e kompensimit të pronave do të caktohet nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, konform Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 dhe Udhëzimit Administrativ Nr.02/2015 "Për zbatimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit që do të përdoren për përllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin".
3. Brenda 10 (dhjetë) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit, konform nenit 8 paragrafi 8 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, bënë shpalljen e Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
4. Kompensimi i pronës së shpronësuar dhe të gjitha obligimet tjera financiare dhe ligjore që mund të rrjedhin nga procesi i shpronësimit do të bëhet nga buxheti i Komunës së Prizrenit.
5. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës), Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Agjencia Kosovare e Privatizimit dhe Komuna e Prizrenit.

6. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/159
Datë: 13.09.2023


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 3, 4, 8, 44 dhe nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 shtator 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet shqyrtimi i mëtejme i kërkesës së Komunës së Rahovecit për shpronësim për interes publik të pronës së paluajtshme ish shoqërore N. Sh. "Jugopetroll", parcela kadastrale Nr. 1817-0 dhe Objektin që menaxhohet dhe administrohet nga AKP, i cili gjendet në parcelën Nr. 1318-1 në pronësi të Komunës së Rahovecit, shpronësimi i të cilave është i nevojshëm për realizimin e Projektit: "Ndërtimi i Sheshit Qendror të Qytetit" Zona Kadastrale: Rahovec, Komuna Rahovec, sipas tabelës të bashkëngjitur këtij Vendimi.
2. Vlera e kompensimit të pronave do të caktohet nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, konform Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 dhe Udhëzimit Administrativ Nr.02/2015 "Për zbatimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit që do të përdoren për përllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin".
3. Brenda 10 (dhjetë) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit, konform nenit 8 paragrafi 8 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, bënë shpalljen e Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
4. Kompensimi i pronës së shpronësuar dhe të gjitha obligimet tjera financiare dhe ligjore që mund të rrjedhin nga procesi i shpronësimit do të bëhet nga buxheti i Komunës së Rahovecit.
5. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës), Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Agjencia Kosovare e Privatizimit dhe Komuna e Rahovecit.

6. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 13/159
Datë: 13.09.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 3, 4, 8, 44 dhe nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 shtator 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet shqyrtimi i mëtejshëm i kërkesës për shpronësim për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga realizimi i 4 (katër) projekteve si më poshtë:
 - Rikonstruktimi dhe zgjerimi i "Deponisë Sanitare" ekzistuese në Landovicë për regjionin e Prizrenit, Zona Kadastrale: Landovicë, Komuna Prizren;
 - Rikonstruktimi dhe zgjerimi i "Deponisë Sanitare" ekzistuese në Velekincë, për regjionin e Gjilanit, Zonat Kadastrale: Velekincë dhe Uglarë, Komuna Gjilan;
 - Ndërtimi "Deponisë së re Sanitare", për regjionin e Prishtinës, Zonat Kadastrale: Puturoc, Ribari i Madh dhe Qylagë, Komuna Lipjan,
 - Rehabilitimi, mbyllja dhe ndërtimi i stacionit të transferit i "Deponisë Sanitare" në Dumnicë e Poshtme, për regjionin e Podujevës, Zona Kadastrale: Dumnicë e Poshtme, Komuna Podujevë, sipas tabelave bashkëngjitur këtij Vendimi.
2. Vlera e kompensimit të pronave do të caktohet nga Ministria e Financave, konform Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 dhe Udhëzimit Administrativ Nr.02/2015 "Për zbatimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit që do të përdoren për përllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin".
3. Brenda 10 (dhjetë) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit, konform nenit 8 paragrafi 8 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, bënë shpalljen e Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
4. Mjetet financiare për pagesën e shpronësimit dhe obligimeve tjera që mund të rrjedhin si rezultat i procesit të shpronësimit do të sigurohen nga buxheti i Qeverisë së Republikës së Kosovës, në Departamentin e Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës).

5. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës), Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Ministria e Ekonomisë dhe Komunitetit, Prizren, Gjirokastrë, Lipjan dhe Podujevë.
6. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 14/159
Datë: 13.09.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 34, paragrafit 12. dhe 13. të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenit 17 paragrafi 3. të Rregullores Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 shtator 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Emërohet Komisioni i Pranimi për Institucionet e Administratës Shtetërore për Grupi Nr. 4, Specialist të Ekonomisë, në këtë përbërje:

- 1.1. Selvete Gjonbalaj, Zyrtare e Lartë për Administrimin e Sistemit të Menaxhimit të Informatave të Burimeve Njerëzore në DMZP/MPB, kryesuese;
- 1.2. Jeton Karaqica, Drejtor i zyrës për Krite Ekonomike dhe Treg të Brendshëm/ZKM, anëtar;
- 1.3. Sebahate Shabani, Udhëheqëse e Divizionit të Administratës/Thesari i Kosovës, anëtare;
- 1.4. Fetije Begolli, Drejtore e Departamentit për Zhvillim të Qëndrueshëm Komunal /MAPL, anëtare;
- 1.5. Faton Ahmeti, Organizata të specializuara "Fox Marble Kosova" anëtar.


Zëvendësues të anëtarëve të Komisionit

- 1.1. Selami Osmani, Zyrtar i Lartë për Politika të Trajnimit dhe Zhvillimit në DMZP/MPB;
- 1.2. Rajmonda Kukalaj, Udhëheqëse e Divizionit të Tregut të Brendshëm dhe Tregut /ZKM;
- 1.3. Hysrije Shatri, Udhëheqëse e Divizionit për Buxhet dhe Financa/ME;
- 1.4. Suzana Kosumi, Shefe e Divizionit për Buxhet dhe Financa/MAPL;
- 1.5. Ganimete Uka, Organizata të specializuara "Infosoft Systems".

2. Komisioni i Pranimi për Institucionet e Administratës Shtetërore për Grupin Specialist i ekonomisë, Grupi Nr. 4 i emëruar sipas pikës 1. të këtij Vendimi ka një mandat dy (2) vjeçar.
3. Anëtarë nga pika 1.5 e këtij Vendimi ka të drejtën e kompensimit sipas nenit 20, paragrafit 1. dhe 2. të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.
4. Komisioni i Pranimi për Institucionet e Administratës Shtetërore për Grupin Specialist i Ekonomisë, Grupi Nr. 4 i emëruar sipas pikës 1. të këtij Vendimi, detyrat dhe përgjegjësitë do t'i ushtrojë në pajtim me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Rregulloren (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës si dhe Rregulloren Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil të Kosovës.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 15/159
Datë: 13.09.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 shtator 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes për Ekstradim ndërmjet Qeverisë e Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Mbretërisë së Suedisë.
2. Obligohet Ministria e Drejtësisë për ndërmarrjen e hapave konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe legjislacionit tjetër në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 16/159
Datë: 13.09.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 shtator 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes për Transferimin e Personave të Dënuar ndërmjet Qeverisë e Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Mbretërisë së Suedisë.
2. Obligohet Ministria e Drejtësisë për ndërmarrjen e hapave konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe legjislacionit tjetër në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 17/159
Datë: 13.09.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 shtator 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes për Ndihmë të Ndërsjellë Juridike në Çështjet Penale ndërmjet Qeverisë e Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Mbretërisë së Suedisë.
2. Obligohet Ministria e Drejtësisë për ndërmarrjen e hapave konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe legjislacionit tjetër në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 18/159
Datë: 13.09.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 shtator 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për Fushën e Shërbimeve të Navigacionit Ajror.
2. Obligohet Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 19/159
Datë: 13.09.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenin 12 par.3 të Ligjit Nr. 08/L-137 për Pyjet, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 shtator 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, për dhënien në shfrytëzim pa kompensim të pronave të kërkuara nga Komuna e Fushë Kosovës për pronat e menaxhuara dhe në pronësi të Republikës së Kosovës për ndërtimin e Objektivit të Njesisë Profesionale për Zjarrfikje dhe Shpëtim, në kuadër të Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave.
2. Përfituesi i së drejtës së shfrytëzimit në të ngastrave P-72514049-00053-0, P-72514049-00054-0, P-72514049-00055-0 është Komuna e Fushë Kosovë dhe Agjencia për Menaxhimin Emergjent.
3. E drejta e shfrytëzimit sipas nenit 1. të këtij Vendimi bëhet për ndërtimin e Objektivit të Njesisë Profesionale për Zjarrfikje dhe Shpëtim.
4. Ngastrat me të dhënat e paraqitura konform kërkesës së Komunës së Fushë Kosovës, regjistrohen si shfrytëzues në emër të Komunës së Fushë Kosovës dhe Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 20/159
Datë: 13.09.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenin 12 par.3 të Ligjit Nr.08/L-137 për Pyjet, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 shtator 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, për Komunën e Hanit të Elezit, për marrjen në shfrytëzim pa kompensim, pronën e menaxhuar dhe në pronësi të Republikës së Kosovës.
2. Përfituesi i së drejtës së shfrytëzimit të ngastrave Nr. 00061-16 dhe 00061-17, konform kërkesës së parashtruar është Komuna e Hanit të Elezit, e cila është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.
3. E drejta e shfrytëzimit sipas nenit 1. të këtij Vendimi bëhet për interes publik të Komunës së Hanit të Elezit.
4. Ngastrat me të dhënat e paraqitura konform kërkesës së Komunës së Hanit të Elezit, regjistrohen si shfrytëzues në emër të Komunës së Hanit të Elezit.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovë

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 21/159
Datë: 13.09.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 shtator 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Ndahen mjetet financiare në vlerë prej 4,200 € (katërmijedyqind euro) për mbulimin e shpenzimeve për transportimin e kufomës së shtetases Argjentinase Maria Clara Urdangaray, nga Prishtina për në Argjentinë.
2. Obligohet Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Më datë 01.09.2023, avokatja e familjes Urdangaray, znj. Lisa Roselli, ka bërë kërkesë në Ministrinë e Drejtësisë për mbështetje financiare, përkatësisht për mbulimin e shpenzimeve financiare për transportimin e kufomës së shtetases së ndjerë Argjentinase Maria Clara Urdangaray, nga Prishtina për në Argjentinë.

Ministria e Drejtësisë duke marrë për bazë aspektin human dhe të ndjeshëm të kësaj çështje, ka proceduar kërkesë në Qeveri për mbulimin e shpenzimeve financiare nga buxheti i Ministrisë së Drejtësisë, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 22/159
Datë: 13.09.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 shtator 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes për Sigurime Shoqërore ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë.
2. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për ndërmarrjen e hapave konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe legjislacionit tjetër në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 23/159
Datë: 13.09.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, Ligjit Nr.08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-213 dhe me Ligjin Nr. 08/L-235, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 shtator 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Ndryshohet dhe plotësohet Vendimi i Qeverisë Nr.13/19 i datës 14.07.2021, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin e Qeverisë Nr. 12/31 të datës 25.08.2021, me Vendimin Nr. 01/49 të datës 17.12.2021, me Vendimin Nr. 15/62 të datës 23.02.2022, me Vendimin Nr. 04/90 të datës 26.07.2022 dhe Vendimin Nr. 20/140 të datës 26.04.2023, ashtu që masës 1. të Pakos së Ringjalljes Ekonomike i shtohet masa 1.10, me tekstin si në vijim:
 - 1.1. Masa 1.10 – Mbështetja e punësimit në ofrimin e shërbimeve publike – 5 milionë Euro
2. Pikat tjera të Vendimit të Qeverisë Nr.13/19 të datës 14.07.2021, ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin e Qeverisë Nr. 12/31 të datës 25.08.2021, me Vendimin Nr. 01/49 të datës 17.12.2021, me Vendimin Nr. 15/62 të datës 23.02.2022, me Vendimin Nr. 04/90 të datës 26.07.2022 dhe me Vendimin Nr. 20/140 të datës 26.04.2023 mbesin të pandryshuara dhe në fuqi.
3. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë